

**Shkup, 12 nëntor 2022 (MIA)** – Ligji i ri për kulturë përgatitet me kujdes. Qëllimi është që të avancohen të drejtat e punonjësve kulturorë, ndërsa risi në ligjin është ajo se do t'u mundësojë punësime të rinjve, të cilët sapo kanë diplomuar në disa nga fakultetet e artit. Nga konkursi, i cili sivjet zhvillohet tërësisht onlajn, pres projekte cilësore, të dukshme, “të zëshme”, ndërsa interes të veçantë të paraqesin personat e rinj dhe gratë, shprehet në intervistën për MIA-n ministrja e Kulturës Bisera Kostadinovska Stojçevska.

Ministrja sqaron se qëllimi i draft-versionit të Ligjit të ri për kulturën, i cili është në përpilim e sipër, është që t'u përgjigjet sfidave të reja të kulturës në vend, e nevoja për të mundësuar punësimin e të rinjve ka lindur për shkak të mungesës së të rinjve dhe stafit të ri në institucionet kulturore.

Këtë vit akademik, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH), siç bëri të ditur, drejtimet – arkitektë, historianë arti, etnologë dhe arkeologë do të vendosen në listën e bursave, ndërsa nga viti i ardhshëm akademik do të trajtohen si staf deficitar, me mundësi për dhënie e më shumë bursave dhe punësim parësor.

Nga Sindikata e Kulturës para do kohë reagues ndaj procedurës me të cilën bëhet miratimi i Draft-versionit të Ligjit të ri për kulturë, duke alarmuar se nuk janë përfshirë në grupet punuese për përpilimin e draftit të ri.

Sipas Kostadinovska Stojçevska, reagimi i Sindikatës është i kuptueshëm, sepse në të kaluarën janë fshehur draft versionet e ligjit.

“Këtë draft version të Ligjit për kulturë vendosëm ta punojmë në faza. Fillimisht, ta përpunojmë në grupin punues në Ministrinë e Kulturës, e tek pastaj t'ua dorëzojmë Sindikatave dhe të marrim vërejtje. E, këtu ndoshta duhet që nga vetë fillimi t'i përfshijmë drejtpërdrejt në mënyrë që të mos vijmë deri te reagimet dhe mosmarrëveshjet e këtilla, ndonëse në vetë grupin e punës ka edhe anëtarë të Sindikatës, por të nominuar nga institucioni. Këtë lëshim e tejkaloam me atë që e përmirësuam zgjidhjen për grupin punues”, shprehet ministrja për MIA-n.



Në pyetjen se sa mjete buxhetore janë ndarë për rikonstrukcionet kapitale sivjet, Kostadinovska Stojçevska informoi se gjashtë projekte investuese janë në rrjedhë, e të cilat janë vazhdimësi e realizimit nga vitet paraprake. Tri janë ndërtime të objekteve të reja në Tetovë, Shkup dhe Strumicë, ndërsa tre janë rikonstrukcione të objekteve ekzistuese në Kumanovë, Koçanë dhe Gostivar.

Sivjet janë filluar nëntë projekte të reja kapitale investuese, si rikonstrukcioni i objekteve të institucioneve kombëtare nga fusha e kulturës.

“Nga këto nëntë projekte, te tri objekte tashmë realizimi është në fazë të avancuar, më saktësisht te BKU Klimenti i Ohrit – Shkup, Muzeu dr. Nikolla Nežlobinski – Strugë dhe Muzeu i Artit Bashkëkohor – Shkup, derisa për gjashtë projektet tjera si QK Prilep, QK Manastir, Muzeu i Maqedonisë, Galeria Kombëtare, QK Strumicë dhe për studim për efikasitet energjetik, sivjet sigurohet dokumentacion i projektit dhe teknik sipas të cilit në vitet e ardhshme duhet të fillojë dhe përfundojë rikonstrukcioni i parashikuar”, tha ministrja.

Po ashtu, Kostadinovska Stojçevska paralajmëroi se deri në fund të vitit në shtetin tonë do të mbahet takimi i parë në kuadër të bashkëpunimit të “Ballkanit të hapur”, në fushën e kinematografisë dhe arteve audiovizuale me përfaqësues nga të tria vendet, ku siç potenconte, në mënyrë plotësuese do të mund të bëhen kontakte për projektet e mëtejshme të përbashkëta, ndërsa do t’i kushtohet kujdes edhe shkëmbimit të përvojave nga emrat me renome në atë fushë.

“Pres që me koleget e mia nga vendet tjera çdo vit edhe më shumë të mbështetemi, si dhe të punojmë në sa më shumë projekte kulturore në të cilat do të përfshihen të rinjtë dhe gratë”, shprehet ministrja e Kulturës për MIA-n.

Ndaj reagimit të Shoqatës së Artistëve Figurativ (SHAFM) të cilët me vite të tëra kërkojnë hapësirë përkatëse për punë, Kostadinovska Stojçevska bëri të ditur se artistëve figurativ u është premtuar se do t’u ndihmohet dhe porositi se problemin do ta zgjidhin së shpejti.



**Në përgatitje është Ligji i ri për kulturë. Çfarë do të thotë saktësisht kjo për kulturën te ne dhe cilat janë ndryshimet kryesore?**

Propozim-ligji i ri për kulturë krijohet me kujdes. Qëllimi i tij është që t’u përgjigjet sfidave të reja të kulturës në Maqedoni. Më e rëndësishme është se me ligjin avancohen të drejtat e punonjësve kulturorë, avancohen dhe saktësohen në mënyrë plotësuese kushtet për audicioni dhe reaudicion, por ajo që është parësore për çdo punonjës kulturor, është ajo se ndryshohen kushtet për punësim ose më saktësisht, vendoset kategori e re e punëtorëve kulturorë – niveli fillestar, përmes të cilit do të mund të punësohen të rinjtë të cilët sapo do të diplomojnë në disa nga fakultetet e artit.

Kjo u shfaq si nevojë për shkak të mungesës së të rinjve dhe kuadrit të ri, kështu që në vend se të shpërngulen të rinjtë jashtë vendit, të punësohen drejtpërdrejt me profesionin. Është me rëndësi

që çdo person i ri që përfundon fakultetin, shansin në vend se të presë për punësim, ai të jetë i punësuar drejtpërdrejt, e jo sikurse deri tani për vendet e punës kërkoheshin së paku 5 vite përvojë pune. Nga ky vit akademik në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, për drejtime të caktuara si arkitektë, historianë arti, etnologë dhe arkeologë do të vendosen në listën e bursave, me atë që nga viti i ardhshëm akademik do t'i trajtojmë si staf deficitar, me mundësi për dhënie të më shumë bursave dhe punësim parësor. Nga ana tjetër, përvojën e tyre gjatë studimeve të rregullojmë me ndryshime në Ligjin për vullnetarizëm në atë mënyrë që gjatë studimeve të tyre do të kenë mundësi të jenë vullnetarë në institucionet për profilin e tyre dhe në këtë mënyrë të përvetësojnë përvojë ende si studentë.

**Nga Sindikata e Kulturës e Republikës së Maqedonisë (SKRM) reagojnë se nuk janë të përfshirë në grupet punuese për përpilimin e draft versionit të Ligjit. Vërejnë se me këtë draft ligj punonjësit kulturorë do të jenë të kufizuar. A i jepet hapësirë e mjaftueshme Sindikatës për dhënie të propozimeve?**

Sinqerisht, reagimi i Sindikatës është i kuptueshëm, sepse në të kaluarën siç theksuan edhe vetë, në të kaluarën draft versionet e ligjit janë fshehur prej tyre, kështu që ata kanë qenë të detyruar të reagojnë post festum.

Në fakt, këtë edhe ata vetë e potencuan në reagimin e tyre me shkrim dhe në konferencë për media. Por, këtë draft version të Ligjit për kulturë vendosëm ta punojmë në faza. Fillimisht, ta përpunojmë në grupin punues në Ministrinë e Kulturës, e tek pastaj t'ua dorëzojmë Sindikatave dhe të marrim vërejtje. E, këtu ndoshta duhet që nga vetë fillimi t'i përfshijmë drejtpërdrejt në mënyrë që të mos vijmë deri te reagimet dhe mosmarrëveshjet e këtilla, ndonëse në vetë grupin e punës ka edhe anëtarë të Sindikatës, por të nominuar nga institucioni.

Kështu që, këtë lëshim e tejkaluam me atë që e përmirësuam zgjidhjen për grupin punues.

### **A do t'i respektoni si Ministri e Kulturës rekomandimet e Qeverisë në pjesën e kontratave kolektive?**

Ministria e Kulturës i respekton rekomandimet e Qeverisë. Në këtë moment, grupi punues krijon kontratë të re kolektive, meqë e vjetra ka skaduar.

Kur do të jetë në fazën përfundimtare, do ta informojmë opinionin.

### **Sa mjete nga buxheti ndani për rikonstruksion për objektet kulturore në vend dhe për cilat objekte kulturore bëhet fjalë?**

Realizimi momental i investimeve kapitale në Ministrinë e Kulturës deri më 15 tetor të vitit 2022 arrin saktësisht 301.590.970,00 denarë, respektivisht 61 për qind nga zëri për shpenzime kapitale i siguruar me buxhetin e Ministrisë së Kulturës.

Deri në fund të vitit, sipas dinamikës së realizimit, pritet që kjo përqindje e realizimit të tejkalojë mbi 90 për qind.

Me programin vjetor për investime në kulturë për vitin 2022 janë parashikuar projekte sipas qëndrimit të përcaktuar paraprakisht të kësaj Qeverie të vitit 2018, respektivisht sipas strategjisë së Qeverisë të mos ketë fillim të ndërtimit të objekteve të reja, por të vazhdohet dhe të përfundojë ndërtimi i objekteve tashmë të filluar, ndërsa të investohet dhe mirëmbahet infrastruktura ekzistuese e institucioneve kombëtare nga fusha e kulturës.

Më saktësisht, investimet kapitale në kulturë që të fokusohet drejt rikonstruksioneve të objekteve ekzistuese.

Sipas kësaj, me Programin vjetor për investime në kulturën për vitin 2022 financohet ndërtimi i teatrit dhe bibliotekës në Tetovë që realizohet nga IK Qendra për kulturë Ilo Anteski Smok – Tetovë si investitor, ndërsa ka filluar të ndërtohet nga viti 2014. Për ndërtimin e këtij objekti, janë parashikuar mjete në vlerë prej 220 milionë denarë. Ky projekt ka filluar nga viti 2014, tashmë është ndërtuar deri në fazën e karabinasë së mbyllur me fasadë. Nga viti i kaluar ka filluar realizimi i fazës për realizimin e të gjitha punëve instaluese, mekanikë dhe teknike skenike, rregullim të enterierit dhe pajisje të objektit. Ky projekt është disavjeçar dhe sipas dinamikës së mjeteve të siguruara financiare, duhet të përfundojë deri në vitin 2027.

Ndërtimi i teatrit i dedikuar për IK Teatri turk – Shkup ndërtohet nga viti 2013, por pas disa viteve është ndalur ndërtimi. Vitin e kaluar është ndarë marrëveshje për realizimin e fasadës dhe çatisë së objektit. Marrëveshja e ndarë për këtë fazë është po ashtu shumëvjeçar dhe realizohet tre vjet, më saktësisht deri në vitin 2023. Për këtë fazë, në vitin 2022 janë siguruar 100 milionë denarë prej të cilëve deri tani janë realizuar 72 milionë denarë. Kjo fazë duhet të përfundojë vitin e ardhshëm, pas çka duhet të vijojë realizimi i punimeve instaluese.

Ndërtimi i Teatrit të vjetër në Strumicë, investitor i këtij objekti është IK Enti dhe Muzeu Strumicë, projekti ka filluar në vitin 2014. Për këtë objekt me Programin vjetor për investime dhe me Buxhetin janë parashikuar 95 milionë denarë, por për shkak të realizimit të ngadalësuar të mjeteve me rebalancin dhe ridedikimin janë ulur në 30 milionë denarë. Për shkak të dinamikës së pakënaqshme të ndërtimit, do të fillojë procedura për ndryshimin e investitorit nga IK Enti për mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe muzeut Strumicë në Ministrinë e Kulturës. Pas zbatimit të procedurës së përgjithshme për ndryshimin e investitorit, pritet që deri në fund të vitit 2023 përfundimisht në Strumicë të ndërtohet teatri i ri.



Rikonstrukcioni i teatrit në Kumanovë, që nga ky vit u vazhdua edhe me financimin e rindërtimit të plotë të objektit, i cili ishte në gjendje mizore, pothuajse në gjendje të papërdorshme, respektivisht përbënte rrezik si për punëtorët ashtu edhe për vizitorët. Në vitin 2022 për rindërtimin e teatrit në Kumanovë realizuam investim në vlerë prej mbi 7 milionë denarë, që ende është në rrjedhë e sipër dhe sivjet realizohen punime në zgjidhjet e brendshme arkitekturore të parashikuara me projektin e miratuar themelor.

Rikonstrukcioni i plotë i IK QK “Beli Mugri” - Koçanë, pas përfundimit me sukses të

rikonstruksionit të çatisë dhe fasadës, këtë vit vazhdoi me rikonstruksionin e brendshëm të objektit, auditorit, me investim prej 8,5 milionë denarë, ndërsa në pritje është edhe montimi i ulëseve në auditor për çka javën e kaluar është dhënë marrëveshja në vlerë prej 7.2 milionë denarë, që duhet të realizohet deri në fund të këtij viti.

Rikonstruksioni i objektit të IK KAÇKM- Gostivar, sivjet vazhdoi edhe me rindërtimin e këtij objekti për të cilin deri më tani janë investuar 400 mijë denarë për një pjesë të ndërtimit të fazës së rindërtimit të fasadës dhe çatisë dhe që do të vazhdojë të realizohet me fazat e radhës të ndërtimit edhe në periudhën e ardhshme.

Si projekte të reja që filluan të realizohen këtë vit dhe të cilat janë parashikuar me Programin vjetor për investime në kulturë janë rikonstruksioni i BKU Klimenti i Ohrit – Shkup, me investim prej 30 milionë denarë, filloi rindërtimi i çatisë në pjesën e vjetërtë objektit. Deri më tani janë realizuar mbi 15 milionë denarë, me qëllim që deri në fund të vitit realizimi i kësaj marrëveshje të përfundojë plotësisht, ndërsa Ministria e Kulturës planifikon të realizojë pjesën tjetër të asaj që është parashikuar në dokumentacionin e projektit për vitin 2023.

Rikonstruksioni i çatisë së IK Muzej të artit bashkëkohor ka filluar, është ndarë marrëveshje e re në vlerë prej 5 milionë denarë, që deri në fund të vitit pritet të jetë i realizuar tërësisht.

Rikonstruksioni i Muzeut IK Dr. Nikolla Nežlobinski - Strugë do të përfundojë sivjet, me investimin e parashikuar prej 4 milionë denarë për rikonstruksionin e fasadës dhe çatisë si fazë e

parë, derisa për fazën e radhës është parashikuar të realizohen instalimet me rregullimin e brendshëm dhe rregullimin e objektit të muzeut.

Më pas vijojnë rikonstruksionet e IK QK Marko Cepenkov – Prilep me sendërtimin e një pjese të re të dedikuar për teatrin, Muzeut të Maqedonisë, Galerinë Kombëtare të Maqedonisë, IK Qendra për Kulturë Anton Panov – Strumicë; për të katër këto institucione, procedura ka nisur sivjet me sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm të projektit dhe teknik, që tashmë është përpiluar dhe është në fazën e rishikimit. Deri në fund të këtij viti presim të realizohet dhe të sigurohen lejet e nevojshme për rikonstruksion në mënyrë që nga viti i ardhshëm 2023 të fillohet me realizimin e punimeve ndërtimore, në varësi gjithsesi nga vëllimi i mjeteve të siguruara financiare në Buxhetin për vitin 2023.

Në rrjedhë është procesi i përgatitjes së furnizimit publik të Ministrisë së Kulturës për fillimin e edhe një projekti tjetër për sigurimin e dokumentacionit të projektit për rikonstruksionin e objekteve të IK Qendra për Kulturë - Manastir dhe IK Teatri Kombëtar - Manastir. Ndryshe, bëhet fjalë për objektet ekzistuese që i përdorin, si dhe për objektin e ish-kinemasë Partizan, e cila një kohë të gjatë është jashtë funksionit dhe paraqez gërmadhë në qendër të Manastirit.

Ministria e Kulturës po përgatit gjithashtu realizimin e projektit për sigurimin e dokumentacionit teknik të nevojshëm, si studim për arsyeshmëri dhe revizione energjetike për projektet për efikasitet energjetik të objekteve që përdoren nga institucionet kombëtare në fushën e kulturës, e të cilat janë konsumatorë më të mëdhenj të energjisë elektrike.

Kjo do të thotë se janë duke u realizuar gjashtë projekte investive, të cilat janë vazhdimësi e realizimit nga vitet paraprake, nga të cilat tre janë ndërtime të objekteve të reja në Tetovë, Shkup dhe Strumicë, dhe tre janë rikonstruksione të objekteve ekzistuese në Kumanovë, Koçanë dhe Gostivar. Derisa, nga ana tjetër, këtë vit kanë filluar nëntë projekte të reja për investime kapitale, si rikonstruksione të objekteve të institucioneve kombëtare në fushën e kulturës.





Nga këto nëntë projekte, te tri objekte tashmë realizimi është në fazë të avancuar, më saktësisht te BKU Klimenti i Ohrit – Shkup, Muzeu dr. Nikolla Nezllobinski – Strugë dhe Muzeu i Artit Bashkëkohor – Shkup, derisa për gjashtë projektet tjera si QK Prilep, QK Manastir, Muzeu i Maqedonisë, Galeria Kombëtare, QK Strumicë dhe për studim për efikasitet energjetik, sivjet sigurohet dokumentacion i projektit dhe teknik sipas të cilit në vitet e ardhshme duhet të fillojë dhe përfundojë rikonstruksioni i parashikuar.

Krahas projekteve të përmendura për investime kapitale, të cilat janë më të rëndësishme edhe për nga vëllimi, edhe për nga përmbajtja dhe për nga shuma e mjeteve, Ministria e Kulturës përmes projekteve të aprovuara në pjesën e mirëmbajtjes investuese të objekteve të institucioneve kombëtare në fushën e kulturës si pjesë e programeve vjetore të punës së institucioneve për vitin 2022, ka aprovuar mbi 100 projekte plotësuese për punë më të vogla për institucionet kombëtare në vlerë prej 50.732.700 denarë. Në kuadër të këtyre projekteve përfshihen të gjitha mirëmbajtjet e domosdoshme investuese dhe rrjedhëse të objekteve nga fusha e kulturës.

**Sivjet në kuadër të Samitit “Ballkani i hapur” në Ohër u mbajt në sesionin plenar të titulluar “Ballkani i hapur hapë kulturë”. Me çfarë rëndësie ishte ky aktivitet për kulturën?**

„Ballkani i hapur“ paraqet iniciativë nga e cila tashmë filluam t’i shohim edhe rezultatet e para – pjesëmarrje e teatrove, operave dhe shkëmbim i përvojave në fushën e kulturës me Shqipërinë dhe Serbinë.

Është me rëndësi të përmendet se deri në fund të vitit në shtetin tonë do të mbahet takimi i parë në kuadër të bashkëpunimit të “Ballkanit të hapur”, në fushën e kinematografisë dhe arteve audiovizuale me përfaqësues nga të tria vendet, ku në mënyrë plotësuese do të mund të bëhen kontakte për projektet e mëtejshme të përbashkëta, por do t’i kushtohet kujdes edhe shkëmbimit të përvojave nga emrat me renome në atë fushë.

Pres që me koleget e mia nga vendet tjera çdo vit edhe më shumë të mbështetemi, si dhe të punojmë në sa më shumë projekte kulturore në të cilat do të përfshihen të rinjtë dhe gratë.

**Gjatë vitit realizuat takime në SHBA, Shqipëri, Kroaci, Greqi. Çfarë epilogu do të kenë këto takime dhe sa janë të rëndësishme për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, për krijimin e strategjive dhe investimin në artistë të rinj dhe për promovimin e kulturës maqedonase?**

Më duhet të theksoj se secili nga këto takime kishte për qëllim tema konkrete dhe të rëndësishme nga kultura, si mbrojtja e trashëgimisë kulturore, shqyrtimit praktik se si funksionojnë shtetet tjera në raport me ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Për shembull, me Dialogun strategjik me SHBA-në punojmë në nënshkrimin e Memorandumit për praktika për parandalimin e vjedhjes për artefakte dhe cilat rregullativa duhet të ndryshohen. Ndërkohë, përmes Fondit të ambasadorëve por rindërtohet Përmendorja e lirisë në Koçanë.

Me Shqipërinë bashkëpunimi është mjaft i zhvilluar dhe është në nivel të lartë dhe më duhet të them se është një nga më intensivët. Me Shqipërinë së bashku e parashtrijmë raportin në UNESCO dhe punojmë së bashku në fushën e përmirësimit të kësaj teme.

Në Greqi, më saktësisht në Kretë, nënshkruam marrëveshje për aderim të Rutave kulturore, program i Këshillit të Evropës, që jo vetëm që e vendosë promovimin e kulturës në vend qendror, por edhe atë që si benefit mund të merret – zhvillim të turizmit, nxitje të ekonomisë lokale, etj.

Në Kroaci me hapjen e Qendrës Kulturore Informativë intensifikohet bashkëpunimi në fushën e kulturës, por ajo që është edhe më e rëndësishme nxisin riafirmimin e katedrave për mësimin e gjuhës maqedonase në universitetet e atjeshme. E gjithë kjo bëhet me kontaktet e ndryshme që realizohen në ato takime dhe me komunikime intensive, me vërtetë shumë mund të dhënë.

**Për momentin është në rrjedhë konkursi për projekte me interes kombëtar në kulturën, në të cilin mund të aplikojnë institucione, shoqata, kompani dhe individë, ndërsa risi është se**

**mund të aplikohet tërësisht onlajn. Cilat janë pritjet tuaja, a konsideroni se përdoruesit do t'i përshtaten lehtë mënyrës së re të aplikimit?**

Pres projekte cilësore, të dukshme, “të zëshme”, e veçanërisht pres që në konkursin të aplikojnë personat e rinj dhe gratë, të cilët do të përpunojnë tema në çdo fushë të jetesës. Konkursi sivjet ishte i vonuar për shkak të vendosjes së risisë së re që të aplikohet tërësisht onlajn, por është i thjesht për të aplikuar.

Është e nevojshme që kultura të kthehet atje ku ishte në shtet – në çdo porre, në piedestalin.

**Çfarë ndikimi ka kriza energjetike mbi institucionet kulturore? A ka rrezik nga zvogëlimi i repertorëve vjetorë?**



Së pari më duhet t'i lëvdoj personat udhëheqës të institucioneve, me të vërtetë e japin maksimumin e vet në mënyrë që të menaxhojnë këtë krizë. Edhe si Ministri edhe si Qeveri jemi duke bërë përpjekje që këtë tronditje të çmimeve ta ulim dhe të mos reflektohet në skenën kulturore.

Por, më duhet të theksoj se repertorët nuk zvogëlohen, meqë kemi projekte të mrekullueshme që janë në skenë, në sallat dhe të ekspozuara në galeritë.

**Nga Shoqata e artistëve figurativ të Maqedoni (SHAFM) tashmë një periudhë të caktuar reagojnë se nuk janë galerinë e tyre ose hapësirë përkatëse për punë. A është gjetur zgjidhje për këtë problem?**

Me Shoqatën e artistëve figurativ jemi në kontakt të rregull dhe si Ministri kemi premtuar se do

t'u ndihmojmë në çdo mënyrë që mundemi.

Në raport me hapësirën, gjithsesi se u nevojitet, kështu që edhe këtë do ta zgjidhim së shpejti.

**Si do ta përfundojë Ministria e Kulturës vitin 2022 dhe cilat janë projeksionet për vitin 2023?**

Këtë vit, 2022, mund të them se ishte vit i sfidave nga çdo aspekt i mundshëm. Do ta përfundojmë me projekte të shumta të suksesshme edhe pse është viti i parë pas pandemisë dhe vit i paparashikueshmërisë së paparë energjetike.

Shpresoj se viti 2023 do të fillojmë me projekte të reja, konkurse, ai do të jetë edhe vit kushtuar Aco Shopovit dhe vit në të cilin do të kremtojmë 120 vite nga festa më e madhe maqedonase – Ilindeni.

**Bisera Trajkovska**

**foto: Frosina Naskoviq**

